



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 92 / Prot.
14

Tiranë, 12.04. . 2021

V E N D I M

Nr. 25 , datë 12.03.2021



P Ë R

MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE
DHE PROGRAMET E INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE,
PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023

Mbështetur në Ligjin 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 25 dhe neni 74, Statutin e Universitetit Politeknik, neni 9, si dhe në propozimet e fakulteteve për kriteret e pranimit në programet përkatëse të ciklit të parë të studimeve dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2022-2023, Senati Akademik me vendim qarkullues të datës 12/03/2021:


V E N D O S I:

1. Të miratojë kriteret e pranimit, për vitin akademik 2022-2023, në programet e ciklit të parë të studimit, Bachelor, dhe në programet e integruara të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Drejtoria e Kurrikulave për të shpallur publikisht kriteret e pranimit në faqen zyrtare të UPT dhe në portalin U-Albania.

Kryetari
Prof. Dr. Andrea MALIQARI



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Kriteret e pranimit në programet e ciklit të parë të studimit dhe në programet e integruara të studimit të ciklit të dytë në UPT, për vitin akademik 2022 – 2023

Kriteret e pranimit për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë, të ofruara nga Fakultetet e UPT, për vitin akademik 2022-2023 janë si më poshtë:

A.

1. Fakulteti I Inxhinierisë Mekanike me programet e studimit:

1. Bachelor në Inxhinieri Mekanike
2. Bachelor në Inxhinieri Materiale
3. Bachelor në Inxhinieri Tekstili dhe Modë
4. Bachelor në Inxhinieri Ekonomike

2. Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave me programet e studimit:

1. Bachelor në Inxhinieri Gjeoinformatikë
2. Bachelor në Inxhinieri e Burimeve minerare
3. Bachelor në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit
4. Bachelor në Inxhinieri Gjeomjedisi
5. Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike

3. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit me programet e studimit:

1. Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi
2. Bachelor në Inxhinieri Hidroteknikë
3. Bachelor në Inxhinieri Mjedisi
4. Bachelor në Inxhinieri Gjeodet

4. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, me programet e studimit:

1. Bachelor në Inxhinieri Matematike
2. Bachelor në Inxhinieri Fizike

kanë vendosur këto kriteret:

- Nota mesatare minimale në hyrje do të jetë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2022 – 2023, në zbatim Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë" neni 74, pika 1).
- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës:

$$[0.7 * Mes_{(VKM)} + 0.3(0.5 * Mes_{(Matematike)} + 0.4 * Mes_{(Fizike)} + 0.1 * Mes_{(Kimi)})] * K_{\text{koef. Shkollës}} * 1000$$

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Ku:

Mes_(VKM), nota mesatare e thjeshtë, e të gjitha viteve të shkollës së mesme, e llogaritur sipas përcaktimeve në Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2022 – 2023, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë" neni 74, pika 1;

Mes_(Matematike), nota mesatare e thjeshtë e matematikës në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin në provimet e Maturës Shtetërore;

Mes_(Fizike), nota mesatare e thjeshtë e fizikës, në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin e kësaj lënde në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore;

Mes_(Kimi), nota mesatare e thjeshtë e kimisë në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin e kësaj lënde në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore;

K_{koef. Shkollës}, koeficienti i shkollës së mesme, për vitin akademik 2022 – 2023, sipas tabelës së koeficienteve për vitin akademik 2022 – 2023.

B.

1. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit me programet e studimit:

1. Bachelor në Inxhinieri Elektronike
2. Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni
3. Bachelor në Inxhinieri Informatike

2. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike me programet e studimit:

1. Bachelor në Inxhinieri Elektrike-Profilu Automatizim i Industrisë
2. Bachelor në Inxhinieri Elektrike-Profilu Energjitikë
3. Bachelor në Inxhinieri Mekatronike

kanë vendosur këto kritere:

- Nota mesatare minimale në hyrje do të jetë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2022 – 2023, në zbatim Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë" neni 74, pika 1).
- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës:


$$[0.7 * \text{Mes}_{VKM} + 0.3(0.6 * \text{Mes}_{\text{Matematike}} + 0.4 * \text{Mes}_{\text{Fizike}})] * K_{\text{koef. Shkollës}}$$

Ku:

Mes_(VKM), nota mesatare e thjeshtë, e të gjitha viteve të shkollës së mesme, e llogaritur sipas përcaktimeve në Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2022 – 2023, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë" neni 74, pika 1;

Mes(Matematike), nota mesatare e thjeshtë e matematikës në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin në provimet e Maturës Shtetërore;

Mes(Fizike), nota mesatare e thjeshtë e fizikës, në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin e kësaj lënde në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore;

K_{koef. Shkollës}, koeficienti i shkollës së mesme, për vitin akademik 2022 – 2023, sipas tabelës së koeficienteve për vitin akademik 2022 – 2023.

C.

Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, për programet e integruara të studimit:

1. Master i Shkencave në Arkitekturë-Profilin Arkitekt
2. Master i Shkencave në Arkitekturë-Profilin Urbanist

dhe për programin e studimit të ciklit të parë:

1. Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn

ka vendosur këto kritere:

- Nota mesatare minimale në hyrje do të jetë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2022 – 2023, në zbatim Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë" neni 74, pika 1).
- Kandidatët do t'i nënshtrohen një testi në hyrje të organizuar nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës.
- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës:

$$0.6 * Mes_{(VKM)} * K_{koef. Shkollës} * 1000 + 0.4 * T_{(Testi)} * 100$$

Mes_(VKM), nota mesatare e thjeshtë, e të gjitha viteve të shkollës së mesme, e llogaritur sipas përcaktimeve në Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2022 – 2023, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë" neni 74, pika 1;

K_{koef. Shkollës}, koeficienti i shkollës së mesme, për vitin akademik 2022-2023.

T_(Testi), rezultati i testimit, i cili përbëhet nga katër (4) komponentë:

- | | |
|--|--------------------------------------|
| • Test i arsimit logjik | 25% T _(Testi) , (25 pikë) |
| • Test i kulturës së përgjithshme | 25% T _(Testi) , (25 pikë) |
| • Test i historisë dhe historisë së arkitekturës | 25% T _(Testi) , (25 pikë) |
| • Test i vizatimit dhe prezantimit | 25% T _(Testi) , (25 pikë) |

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al

